



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës,  
mbajtur më 28.3.2025.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina - kryesues i Komitetit, Nora Kelmendi (VV), Mirsad Vitia (VV), Arbnora Berisha (VV), Gëzim Sveçla (VV), Jeta Rafuna (LDK), Milazim Vitija (LDK), Dhurata Jahaj - Retkoceri (LDK), Shegë Beqiri - Badivuku (PDK) dhe Leutrim Retkoceri (PDK).

Mungoi: Bahri Gashi (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Arbër Sadiki, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Komitetit, me këtë

### REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar artistit Faruk Begollit;
3. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit të memorialit kushtuar dëshmorëve Hyzri Talla, Afrim Malqi dhe Ilir Durmishi;
4. Propozim-vendimi për përkrahjen financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar;
5. Propozim-vendimi për definimin e kufirit në mes bllokut A6 dhe A7 të Planit rregullues "Prishtina e Re- Zona Qendër";
6. Propozim-vendimi për hartimin e planit të hollësishtëm rregullues Çagllavicë;
7. Propozim-vendimi për subvencionimin e transportit të nxënësve;
8. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare shoqatës "Yjet që nuk vdesin";
9. Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 30 dhjetor 2024 (TM4);
10. Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2024;
11. Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025-2026;
12. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;

13. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtime të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytete, me nr. 01-020/05-69243/23, dt. 3.4.2023;
14. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031;
15. Propozim-vendimi për miratimin e Rregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës;
16. Të ndryshme.

**Gëzim Sveçla** tha se pikë e tetë e rendit të ditës “Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare shoqatës “Yjet që nuk vdesin”, duhet të largohet, për shkak se ka pas të bëjë me festën e 17 shkurtit, por edhe ligjërisht nuk ka qenë në rregull.

**Kryesuesi** u shpreh i pajtimit që të largohet nga rendi i ditës.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se, për shkak të zhvillimeve të fundit lidhur me çështjen e menaxhimit të mbeturinave, konferencave të mbajtura, Vendimit për pezullimin e Rregullorës dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese, propozojmë që si pikë e rendit të ditës të jetë “Rekomandimi për zbatimin e vendimeve të Kuvendit dhe nënshkrimin e kontratës”, nga marrëveshja paraprake me KFW-në gjermane, e nënshkuar nga vetë Kryetari i Komunës së Prishtinës. Ai tha se i kam të shënuara të gjitha pikat lidhur me këtë rekomandim, por 3 më të rëndësishmet janë: respektimi i Vendimeve nga Kryetari i Komunës, të miratuar nga Kuvendit i Komunës; zbatimi i marrëveshjes së lidhur mes kryetarëve të komunave dhe KFW-së për nënshkrimin e kontratave 10-vjeçare për garantimin e kredisë dhe grantit; dhe ofrimi i palëve në realizim e kunërdërshtimit të çdo mënyre të dështimit të këtij granti, që përgjegjësia të mbetet në anën e secilit që kundërshton. Retkoceri propozoi që si pikë e rendit të ditës të jetë edhe “Propozim-vendimi i subvencionimit të ndërmarrjes “Pastrimi””. Ai deklroi se i kemi pranuar dy kërkesa për subvencionim nga kompania, të cilat bazohen në të hyra mjaft të vogla në tremujorin e fundit, e sidomos pas njoftimit zyrtar nga kryetari, i cili iu bënë apel që të mos bëhet pagesa e faturave të ardhura nga kompania “Pastrimi”. Duke u bazuar në këto kërkesa, Leutrimi tha se duke i parë humbjet e mëdha të kompanisë, borxhet e mëdha kundër deponisë dhe ato të naftës, janë përafërsisht diku 4.3 milionë euro. Kërkesa e tyre është që nga ky subvencionim të ndahen 1.2 milionë euro. Retkoceri theksoi se ideja e rekomandimit nuk është diçka detyruese, por ideja e saj është që në rast të humbjes në çfardo llojë situate të realizimit të projektit të KFW-së, përgjegjësinë për humbjen mos ta marrim ne si Kuvend, por ajo të jetë mbi Kryetarin e Komunës. Për ndryshe, ai tha se ka marrëveshje mes kryetarëve të komunave dhe KFW-së gjermane, të cilët janë zotuar se do t'i mbajnë përgjegjësitë e tyre, sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, që t'i kryejnë obligimet dhe të sigurojnë një stabilitet financiar për ndërmarrjet.

**Valbona Makolli** theksoi se si pasojë e mosaprovimit të buxhetit në afatin buxhetor, jemi pa buxhet nga fillimi i vitit 2025. Pra, investimet kapitale janë komplet të bllokuara, asnjë centë nuk është i rialokuar deri në aprovimin e buxhetit nga Kuvendi i Kosovës. Drejtoresha bëri të ditur se, për shkak të kësaj ju mund të miratoni çfardo lloj vendimi, por nuk dihet se kur mund t'i realizojmë ato vendime.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se është për keqardhje mungesa e zyrtarëve ligjorë të Komunës në mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa, edhe pse nuk ka efekt ligjor detyrues.

Ai tha se e përkrahim kërkesën për rekomandimin, që t'u përbahemi kontratave ose kushteve të nënshkruara qoftë nga ana e zyrtarëve të Komunës, apo nga ndërmarrja “Pastrimi”, por e kundërshtojmë dhe nuk e votojmë kërkesën për subvencionim, sepse në katër vitet e fundit jemi duke ndarë mjete, por stabiliteti financiar nuk ruhet duke vepruar në këtë mënyrë.

**Propozimi i parë:** Rekomandim për Kryetarin e Komunës së Prishtinës lidhur me respektimin e akteve që dalin nga Kuvendi i Komunës, votohet më 9 vota për, zero kundër dhe një abstenim, që të jetë si pikë e rendit të ditës në mbledhje të Kuvendit.

**Leutrim Retkoceri** tha se në bazë të kërkesës nga ndërmarrja “Pastrimi”, shuma e kërkuar për këtë subvencionim është 1.2 milionë euro, e cila ka të bëjë me një borxh të vjetër të deponisë që nuk po mundet me u paguar, dhe për pagesën e trustit të punëtorëve që nuk janë realizuar për shkak të realizimit të pagave.

**Propozimi i dytë:** Propozim-vendim për subvencionimin e Ndërmarrjes regionale KRM “Pastrimi”, votohet me 5 vota për, 4 kundër dhe 1 abstenim, që të jetë si pikë e rendit të ditës në mbledhje të Kuvendit.

**Pika e parë.**

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa, votohet njëzëri nga anëtarët e Komitetit.

**Pika e dytë.**

Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar artistit Faruk Begoli;

**Nora Kelmendi**, tha se herën e kaluar kur kemi diskutuar për këtë propozim, kam parashtruar pytje për departamentin ligjor pasi që kjo pronë është në pronësi të Republikës së Kosovës dhe PSH Kuvendit të Kosovës. Ajo pyet drejtorinë se a keni ndonjë diskutim zyrtar, pasi që duhet ta keni një shkresë, me të cilën ju kanë lejuar këta pronarë legjitimë për të vendosur diçka aty?

**Arbër Sadiki**, tha se kemi komunikuar në e-mail me zyrtarë të Ministrisë së Kulturës, por me këtë Vendim ne nuk jemi duke ia dhënë në shfrytëzim apo duke vendosur memorialin, jemi vetëm duke planifikuar dhe çdo planifikim bëhet në gjithë territorin e Prishtinës, pa marrë pëlqime në momentin e planifikimit prej poseduesve. Sadiki tha se në draftin e Vendimit shënon që pas caktimit të lokacionit do të fillohet procedura për bashkëpunim me akterët e tjera. Pra të gjitha planifikimet bëhen në këtë mënyrë, pasi që nuk jemi duke e marrë atë pronë por vetëm duke e planifikuar.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se nuk jemi asnjë kundër miratimit të këtij Vendimi, por ideja e gjithë kësaj është që pas shqyrtimit të ligjshmërisë nga Ministria të mos kemi përgjigje negative, ashtu siç ka ndodhur me disa vendime të kaluara. Sveçla tha se ndoshta do të ishte më mirë që paraprakisht të marrim dakordim prej institucionit që mundeni me caktu këtu dhe pastaj të fillojmë me procedurat tjera.

**Arbër Sadiki** theksoi se për t'i larguara këto probleme që janë shfaqur më herët, ku me një Vendim për caktimin e lokacionit kanë realizuar memorialin, tash kemi krijuar një fazë të dytë, që fillimi shëtë planifikojmë dhe pastaj të fillojimë me procedurat e realizimit të memorialit.

**Pika e tretë.**

**Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin, kushtuar dëshmorëve Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi.**

**Nora Kelmendi** tha se për këtë Vendim paraprakisht është dashur të bëhet ndarja e parcelës, andaj nuk kemi çfarë të diskutojmë për këtë pikë.

**Leutrim Retkoceri** pyeti se a ka ndonjë bashkëbisedim me familjarët e këtyre dëshmorëve.

**Arbër Sadiki** theksoi se ne kemi pasur një takim me disa prej ish-bashkëpuntorëve dhe jemi dakorduar që kjo nuk është një vazhdimësi memoriale që është bërë deri sot, me të cilën as ata vetë nuk është se janë të kënaqur. Drejtori tha se pasi të caktohet lokacioni, shpallet konkursi, realizohet vepra, por kjo është vetëm një caktim lokacioni në një hapsirë publike. Sadiku tha se kemi planifikuar dhe do të mbajmë takime edhe me familjarët e dëshmorëve.

**Pika e katërt.**

**Propozim-vendimi për përkrahjen financiare për familjet strehuse dhe fëmijët në strehim, pikë e diskutuar nga mbledhja e kaluar.**

**Pika e pestë.**

**Propozim – vendimi për definimin e kufirit në mes te bllokut A 6 dhe A 7, të Planit rregullues “Prishtina e Re - Zona Qendër”.**

**Arbër Sadiki**, tha bëhet fjalë për mospërputhjen e grafikave ndërmjet bllokut A6 dhe A7 në Planin rregullues “Prishtina e Re - Zona Qendër”. Ai tha se kjo pjesë është e përfshirë në disa harta në bllokun A6 dhe në disa harta tjera në bllokun A7, e cila pamundëson realizimin në atë pjesë, pasi që kemi ndryshime të koeficienteve. Andaj, propozimi është që të kemi ndarje gjemotrikisht të rregullta dhe disa nga këto parcella të cilat kalojnë në bllokun A7, do të kenë edhe zvogëlim të koeficientit.

**Nora Kelmendi** pyet drejtorin se a ekziston përputhje në mes pjesës grafike dhe tekstuale, dhe këto parcella të cilat kanë ulje të koeficientit a mendon se do të paraqesin problem.

**Arbër Sadiki**, tha se kemi disa lëshime sa i përketë pjesës grafike dhe asaj tekstuale, ndërsa për ndryshimin e koeficienteve edhe ne në fillim kemi hezituar për një iniciativë të tillë, mirpo ka qenë kërkesë e vetë banorëve për korrigjim sepse kanë qenë të bllokuar.

**Leutrim Retkoceri** pyet drejtorin se a është e mundur që drejtoria me një vendim me lëshu lejen dhe me vazhduar me procedura.

**Arbër Sadiki**, tha se kjo nuk është e lehtë, sepse drejtoria punon me ata zyrtarë që i ka brenda dhe asnjë zyrtarë nuk e ka guximin me marrë një Vendim kur bëhet fjalë për ndryshime të tilla me peshë për ndryshim të koicientit apo investimit.

**Gëzim Sveçla** pyeti se ligjërisht kur e ndryshojmë kufirin, a ndryshojmë edhe në përbajtjen e Planit rregullues.

**Arbër Sadiki** tha se po të ishte diskrepancë me ndryshimin e kufirit, ne do të ishim obliguar me trajtuar si plotësim-ndryshim të Planit rregullues, paraprakisht si inicim, diskutim publik, e pastaj Vendim, por jemi duke propozuar vetëm një rregullim të një problemi teknik.

**Nora Kelmendi** pyeti drejtorin se pse të gjitha këto nuk kryhen në Drejtorinë e Kadastrit.

**Arbër Sadiki** sqaroi, duke thënë se kjo ka të bëjë me planifikim dhe pastaj me kadastër, pjesa e riparcelimit tregon se qysh kanë me marrë formë parcelat mas marrjes së lejes ndërtimore. Drejtori tha se këtu jemi në fazën që nuk po munden as kushtet ndërtimore me u marrë, sepse problemi është tek urbanizmi se në cilët parametra me u zhvilluar.

**Nora Kelmendi** pyeti drejtorin se a e keni shikuar hartën e vjetër në Drejtorinë e Kadastrit, për t'u krahasuar se qysh është dhe a mundet me e rregullu këtë çështje.

**Arbër Sadiki** theksoi se gjendja kadastrale është e njëjtë prej kur është hartuar plani e deri sot janë të pandryshushme dhe nuk kemi ndonjë problem me ndonjë ndryshim që ka ndodhur me bashku me parcela, parcelat janë të njëjtë por vetëm ndarjet e bllokut ku precizohen parametrat urbanistikë.

**Gëzim Sveçla** pyeti drejtorin se, pasi ta bëjmë këtë definim të kufirit, a kemi këtu ndryshim të Planit rregullues. Sveçla tha se pas këtij ndryshimi sipërfaqja e planit nga 68 mijë metra katrorë tash bëhet 80 mijë metra katrorë dhe pas shqyrtimit të ligshmërisë mund të kemi përgjigje negative nga MMPhi-ja, pasi që duhet të bëhet revidim i Planit.

**Arbër Sadiki**, tha se revidim të planit duhet të kishim bërë po të kishin qenë krejt hartat njëjtë, ta ndryshonim një kufi, sepse po duam një zonë me kthye prej një koeficienti në koeficientin tjetër, por këtu nuk jemi duke e bërë këtë gjë, sepse këtu vetëm jemi duke e përmirësu një problem teknik. Sadiki tha se propozimi i ndryshimit të koicientit është bërë sepse nuk kam dashur që me ndryshimin e kufirit të rritet edhe dendësia.

**Nora Kelmendi** pyeti se a i jeni drejtar Zyrës ligjore për këtë Vendim në lidhje me definimin e kufirit dhe a keni pranuar ndonjë opinion ligjor.

**Arbër Sadiki** tha se unë teknikisht kam bërë përgatitjen e dokumentave dhe i kam përcjellë ato në Zyrën ligjore, pastaj të njëjtit, në përputhje me dokumentacionin, kanë hartuar propozim-vendimin për të cilin jemi duke diskutuar.

**Pika e gjashtë.**

**Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullus - Çagllavicë, i diskutuar në mbledhjen e kaluar.**

**Pika e shtatë.**

**Propozim-vendimi për subvencionimin e transportit të nxënësve, i diskutuar në mbledhjen e kaluar.**

**Pika e tetë.**

**Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 30 dhjetor 2024, TM 4, i diskutuar në mbledhjen e kaluar.**

**Pika e nëntë.**

**Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar- 31 dhjetor 2024, TM4, i diskutuar në mbledhjen e kaluar.**

**Pika e dhjetë.**

**Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025-2026, i diskutuar në mbledhjen e kaluar.**

**Pika e njëmbëdhjetë.**

**Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025, i diskutuar në mbledhjen e kaluar.**

**Pika e dymbëdhjetë.**

**Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtime të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet, me nr. 01-020/05-69243/23, dt. 3.4.2023, i diskutuar në mbledhjen e kaluar.**

**Pika e trembëdhjetë.**

**Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031, i diskutuar në mbledhjen e kaluar.**

**Pika e katërmëbhjetë.**

**Propozim-vendimi për miratimin e Rregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës, i diskutuar në mbledhjen e kaluar.**

**Pika e pesëmbëdhjetë.**

**Të ndryshme.**

**Mbledhja mbaroi në orën 11:30.**

**Procesmbajtësi  
Arton Brahimë**



**Kryesues i Komitetit  
Fehmi Kupina**